

afer Malishevës/Mališevo, ku menjëherë ndërroi jetë. Bashkëlufëtaret e kishin bartur në xhaminë e fshatit Shalë/Sedlare [Lipjan/Lipljan]. Ai u varros në nesërmen në Rusinoc/Rusinovce. Pas lufte, më 20.07.2000, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në fshatin Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan].

Burimet: deklaratat S.S, FDH-23620; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; fotografi FDH-21039; fotografi, FDH-25070; SHFDUÇK, *Feniksët...2*, 225-228; fotografi, FDH-34248.

Osman (Ramadan) Halimi

(12.05.1952, shqiptar nga Belinca/Belince, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, dhjetë fëmijë)

Familja e Osmanit e kishte braktisur fshatin Belince/Belince, në maj të vitit 1998. Bashkëshortja e tij Qerimja dhe fëmijët, së bashku me banorët e tjerë të fshatit, qëndruan për shtatë ditë në pyll. Osmani u siguronte ushqime dhe në mbrëmje kthehej në shtëpi. Më pas, kishin shkuar te vajza e Qerimes dhe Osmanit, Afërdita, dhe dhëndri Ramadan Krasniqi, në fshatin **Dugë/Duga**. Osmani erdhi më 23.07.1998. Në mëngjesin e hershëm të datës **30.07.1998**, forcat serbe e filluan granatimin e fshatit. Fshatarët kishin ikur nga fshati. Osmani ishte nisur me familje, por së shpejti e ndërroi mendjen dhe u kthye. Me të qëndruan Ramadani dhe i vëllai Sabriu. Po atë ditë, më vonë, Osmani, Ramadani dhe Sabriu kishin vendosur që të iknin. Dolën në oborr dhe, në atë çast, pranë tyre eksplodoi një predhë. Ciflat e predhës Osmanin e qëlluan në kokë, me ç'rast ai ndërroi jetë në vend. Po atë ditë Ramadani dhe Sabriu u varrosën në pyll. Në qershor të vitit 2000, familjarët dhe fqinjët e familjes Halimi i rivarrosën mbetjet mortore të Osmanit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Belincë/Belince.

Burimet: deklaratat Q.H, FDH-23571; deklaratat Q.H, FDH-36719.

Miroslav (Jova) Perić

(8.04.1952, serb nga Ferizaj/Uroševac, tre fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Miroslavi u lind në Han të Elezit/Đeneral

Janković [Kačanik/Kaçanik]. Në MPB të Serbisë kishte punuar nga janari i vitit 1994. Kur filloi lufta, punonte në Drejtorinë për Lidhje në SHPB e Ferizajt/Uroševac. Në datën **31.07.1998**, rreth orës 4:30, Miroslavi u plagos gjatë sulmit të pjesëtarëve të UÇK-së mbi policinë në **Zborc/Zborce**. Pas tri ditësh, ai ndërroi jetë në AMU në Beograd.

Burimet: SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 51; SMIP, *Teroristički...*, III, 937; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832; Politika, Miroslav Perić, përkujtimi në shtyp, 5.08.1998, FDH-20743; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998.godini*, na <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078.

Saša (Radojica) Janković

(18.09.1972, serb nga Budrika e Poshtme/Donja Budriga, komuna e Gjilanit/Gnjilane, konduktor, i pamartuar, luftëtar)

Saša jetonte me prindërit, Radojica dhe Todora dhe motrën Sanjen në Budrikë të Poshtme/Donja Budriga. Ai punonte si konduktor në *Kosmet-prevoz* në Gjilan/Gnjilane. Gjatë verës së vitit 1998, Saša disa here mori thirrje për tu inkuadruar në policinë rezerve. Ai asnjëherë nuk iu përgjigj thirrjes, ngase babai i tij e kundërshtonte këtë. Në datën 31.07.1998, derisa babai nuk gjendej në shtëpi, policia erdhi dhe e mori Sašën. Dy ditë më vonë, më **02.08.1998**, policia e lajmëroi familjen se Saša e kishte humbur jetën gjatë një sulmi të UÇK-së mbi pozicionet e policisë në **Carralëvë/Crnoljevo**. Familjarët e varrosën atë më 3.08.1998 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklaratat J.R, FDH-35234; SMIP, *Teroristički...*, III, 936; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 30; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 190; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex. D312.52, FDH-30993; *Sahranjen Saša Janković*, Politika, 04.08.1998, FDH-34227.

Selim (Rexhep) Rexhaj

(1923, shqiptar nga Petrova/Petrovo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, shtatë fëmijë)

Selimi jetonte me të birin Hetemin dhe